



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 78/1 Prot

Tiranë, më 26 ,12 2011

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr. 31 , datë 26/12 2011

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë Nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nenit 78,79 të Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Av. Luan Merlika**, me adresë: Bul” Zogu i Parë”, VEVE Business Center, Tiranë.

KONSTATOVA

Sipas Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në cilësinë e avokatit, ju jeni kontrollues, sipas përcaktimeve të nenit 3/3 të ligjit të sipërcituar: “Kontrollues, është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale”, pra keni përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji.

Pranë Komisionerit të Mbrojtjes së të dhënave Personale, është paraqitur ankesa e Shoqërisë “Roefix”, që ka të bëjë me list-pagesat e punonjësve të kësaj shoqërie për periudhën Janar 2009-Dhjetor 2010, list-pagesë e cila disponohet nga ana Juaj.

Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Z. (ish-punonjës i Shoqërisë “Rofix”), me anë të kërkesës Nr. 27/1 prot, datë 21.07.2011 ju keni kërkuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë listpagesën për periudhën e sipërcituar, për punonjësit e shoqërisë “Rofix”.

Me anë të shkresave Nr. 8522 prot, datë 16.08.2011, 8047/1, datë 19.07.2011 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë ju është vënë në dispozicion listpagesa për periudhën e sipërcituar, fotokopje e njësuar me origjinalin. Kjo listë është e detajuar dhe përmban listpagesën e kontributeve shoqërore, shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të të gjithë punonjësve të kësaj shoqërie.

Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” , nenit 5, gërma b,c, i cili shprehet: b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c) “..të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim”, të dhënat që ju keni grumbulluar si rezultat i korrespondencës me DRSSH, Tiranë e tejkalojnë qëllimin

për të cilin janë mbledhur. Ju keni grumbulluar të dhëna personale jo vetëm për klientin që keni përfaqësuar ligjërisht, por edhe për të gjithë punonjësit e tjerë të shoqërisë “Rofix”, çfarë rezulton në kundërshtim me nenin e sipërcituar.

Mbledhja e të dhënave për gjithë punonjësit, pa dijeninë e tyre, pa patur lidhje të drejtpërdrejtë me çështjen e personit që ju ligjërisht keni përfaqësuar pranë organeve gjyqësore, cënon rëndë privatësinë e çdo individi, punonjës i shoqërisë “ Rofix”.

Përdorimi i të dhënave të këtyre punonjësve në mënyrë të paautorizuar, mund të sjellë dëme të rëndë dhe të pariparueshme në lidhje me interesat e tyre dhe privatësinë, si një nga të drejtat themelore të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Neni 35 dhe në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në referencë të nenit Neni 30/1/b të ligjit të sipërcituar 1. Komisioneri ka këto të drejta:
b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;

Ndërkohë sipas Kodit të Procedurave Administrative Neni 78, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të dalë me vendim të ndërmjetëm.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 5/1/b,c, 30 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe neneve 78, 79 të Kodit të Proceduravë Administrative:

V E N D O S A

1. Bllokimin dhe pezullimin e përpunimit të mëtejshëm nga ana juaj të të dhënave personale që përmbahen në listpagesat e punonjësve të shoqërisë “Rofix” për periudhën janar 2009-dhjetor 2010, deri në dhënien e vendimit përfundimtar në lidhje me çështjen nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 23.12.2011.

KOMISIONERI

Flora ÇABEJ (Pogaçe)

